ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

QUMËSHT UHT TETRAPACK

Bazuar ne STASH 1563/87, Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Kërkesat cilësore :

Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.

Gjate përpunimit dhe tregtimit të zbatohen rregullat higjieno sanitare e veterinare në fuqi. Nuk duhet të lejohet përdorimi i lendeve konservuese, neutralizuese dhe të huaja.

Te plotësojë treguesit organo-leptike dhe ato fiziko-kimike.

Pamja e jashtme:

Te jete leng homogjen, pa lende të huaja që notojnë apo precipitojnë me rrjedhje të njëllajtë dhe pa ndërprerje.

Ngjyra e bardhe e njëllajte, nuance e lehte e verdhë .

Shija dhe era të këndeshme, lehtësisht e ëmbël, pa shije ose ere të huaj.

Qumeshti duhet të jete i ambalazhuar në kuti tetrapak në peshe 1Lit dhe i shoqeruar me Raport Analizë “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analizë Mikrobiologjike” nga institucione ligjorë.

Treguesit fiziko-kimikë:

1. Dendësia në 20 gradë celcius jo më pak se 1.028 – 1.029 gr/litër.
2. Pika e ngrirjes jo më e lartë se –0,520 gradë C
3. Përmbajtja e yndyrës në %, 3-3.4 %.
4. Aciditeti në grade Tjorner:

Në periudhën 01 Tetor – 31 Mars jo me I lartë se se 19 Në periudhën 01 Prill – 30 Shtator jo me I lartë se se 20

5. Përmbajtja e lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se 8.5 %

6. Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidezes) duhet negative. Pastertia pa mbetje me site mendafshi apo merle pambuku dyfishe.

Amballazhimi brenda kushteve higjieno-sanitare ,me peshe 1.4 lit ku te jene vendosur: Marketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit. Data e prodhimit.

Data e skadimit. Përqindja e yndyrës.

Temperatura e ruajtjes së produktit.

Analiza mikrobiologjike

1.Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Rruajtja e transportimi ne temperature 2 deri ne 8 grade.

Ngarkesa mikrobike sipas normave te percaktuara nga Ministria e Shendetesise. Malli duhet të shoqerohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobilogjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

STASH 1443-87

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr.234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Kërkesat cilësore

Të plotesoje treguesit e cilesise si me poshtë:

- Ngjyra: e bardhe, në sipërfaqe e bardhe lehtësisht në krem.
- Strukturta: e ngjeshur, pa pore, ne prerje pa shtresa dhe ndarje hirre.
- Era dhe shija: e kendeshme, karakteristike e kosit te embel, lehtësisht e tharte

Treguesit fiziko-kimikë:

- Aciditi ne grade Tjorner jo më shume se 120
- Yndyra në % 2 ± 0.1
- Ngarkesa mikrobiale sipas normave te miratuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi,marketimi dhe etiketimi

Kosi ambalazhohet ne paketim tetrapack, shishe qelqi ose plastike, me grykë të gjerë, me mase 500g-1 kg te mbyllur me kapak.

Ambalazhet qe perdoren te jene ne gjendje te mire,te paster,te thata dhe pa ere te huaj.

Meteriali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjenosanitare nga standardet përkatëse.

Shmangiet e lejuara ndaj vellimit nominal te kosit te amabalazhuar jane:

- ± 20 g per ambalazhet 1000 g

- ± 15 g per ambalazhet 500 g

Ne cdo paketim vendoset etiketa ku shenohet:

- Emri i ndermarjes prodhuese

- Perqindja e yndyres

- Data e prodhimit

- Data e skadimit

- Standarti ne fuqi

Etiketimi i kosit të amabalazhuar ne kuti behet me stampim.

Ruajtja dhe transporti:

Kosi ruhet e tregëtohet në frigorifer në temperatura nën 100 C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur. Koha e ruajtjes në frigorifer është 24 orë nga koha e prodhimit.

Transporti bëhet me mjete të, mbuluara, të pastra ose me mjete frigoriferike.

Analize mikrobiologjike

Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

Malli duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobilogjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

DJATH I BARDHË

Bazuar ne STASH 1410/87.

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr.

234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Lloji: Djath fetë cilësia e pare (lope)

Te jetë i stazhionuar jo me pak se 45 dite, te mos jete i falsifikuar me niseshte apo lëndë të huaja.

Ngjyra: E bardhë deri në krem

Forma: prizem, trekendesh me nje faqe anesore cilindrike.

Masa e formes ne g, 0.5-1 kg.

Pamja e jashtme dhe e brendshme: e formuar mire, e paster dhe pa njolla.

Lejohen plasaritje të lehta ne siperfaqe. Ne prerje është e njellojte, e paster, pa lende të huaja me sythe teknike, me ngjyre të bardhe deri ne krem.

Struktura dhe konsistenca: e lemuar, jo e forte dhe pa dallim shtresash.

Era dhe shija: E këndshme, specifike e djathit të bute të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse, pa shije e ere të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

1-Lageshtira ne % , jo me shume se:

Per periudhen 1.05- 30.09, %“52”

Per periudhen 1.10.- 30.04, %“56” 2- Lendet e thata ne %,jo me pak se

Per periudhen 1.05- 30.09, %“48”

Per periudhen 1.10.- 30.04, %“44”

3- Yndyra ne lendet e thata në %, jo më pak se % 30-60 4- Kripë në % deri 4 ± 1 .

-
- 5- Ngarkesa mikrobike, brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.
- 6- Në çdo parti djathi lejohen deri në 5 % copa dhe 2 % therime, masa e një cope me e madhe ose e barabartë me 50 gr.

Analiza mikrobiologjike (bazuar urdhri 645, dt.23.12.2016)

E-coli 100-1000 cfu/ml

Staphylococci 100-1000 cfu/ml

Malli duhet të shoqerohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

Ambalazhimi:

Brenda kushteve higjieno - sanitare, i ndarë në pesha të vogla nga 0.5, 1, 2, 3, 4, 5 kg, sipas kërkesave të Entit.

Në rastet kur djathi është i ndarë në pesha të vogla, secila copë duhet të ambalazhohet me material ambalazhues të lejuar dhe të përshtatshëm për këtë produkt.

Mbi çdo ambalazh me djathe vendoset etiketa në të cilën shenohen: Marketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit (lloji i djathit) Cilësia

Masa neto.

Data e prodhimit. Data e skadencës

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi. Kur djathi është i ambalazhuar në kuti kartoni tretrapack, në kuti duhet të shenohet: emërtimi i produktit, data e prodhimit, data e skadences dhe treguesit fiziko-kimikë.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zevendesuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.

Malli të shoqërohet me çertifikatë orgjine dhe raportë analize sipas legjislacionit në fuqi.

Ruajtja dhe transporti:

Rruajtja: Në frigorifer për 12 muaj në temperaturë nga 3 deri në 5 gradë C, lagështia relative e ajrit 95 %.

Transporti I djathit bëhet me mjete frigoriferike.

GJIZA PA KRIPË

STASH 1424/87

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr.

234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Lloji: Gjize e fresket dhe pa kripe, cilesia e parë

Pamja: E pastër, me ngjyrë të bardhë, lehtësisht në gri.

Struktura : e njellojte ne te gjithë masen, pa therrime djathi.

Era dhe shija : e kendeshme, karakteristik e gjizes se fresket, lehtesishte ne te embel, pa shije thartire.

Treguesit fiziko kimikë:

1-Lageshtira ne % , jo me shume se 68 2-Yndyrë ne e %, jo me pak se 3.

Analiza mikrobiologjike

Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shendetesise.

-E-coli 100-1000 cfu/ml

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

Ambalazhimi: Gjiza e fresket ambalazhohet ne vasketa plastike të valezuar me mase 0.5 kg.
(sipas kerkeses se entit).

Mbi cdo ambalazh me gjize vendoset etiketa ne të cilen shenohen:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit.

Pesha neto ose vëllimi i produktit. Data e prodhimit.

Data e skadencës.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkëputet nga ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire,të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

Ruajtja dhe transporti:

Gjiza ruhet ne frigorifer ne temperature 2-4 gradëC, Transportimi i gjizes behet me mjete frigoriferike.

GJALPI

Gjalpi duhet të jete i freskët, cilesi e pare.

Treguesit organo-shqisor:

Pamja: Mase e ngjeshur, uniforme, pa lendë të huaja. Pa shtresa ndërprerje, me siperfaqe të ndritur, pa pika uji.

Konsistenca: Gjysëm e fortë.

Ngjyra: Krem deri në të verdhë.

Aroma: Karakteristikat e produktit, pa erëra te huaja.

Shija: Shije kremi, karakteristike e gjalpit të freskët, të tretet lehtë në gojë.

Treguesit fiziko-kimik:

1. Lageshtia në përqindje 16%
2. Yndyra në përqindje 81%
3. Kripa në përqindje 0%
4. Aciditeti 2.1
5. Lëndë të thatë në përqindje 2%

Ambalazhimi: Në kuti kartoni të valëzuar në masën 10-25 kg të veshur nga brenda me letër ose qese. Mbi çdo kuti kartoni të jetë etiketa ku ka të shënuar: Emrin dhe vendi i ndërmarrjes prodhuese, lloji i produktit dhe cilësia, data e prodhimit, e skadenca. Masa bruto e neto, vula e cilesisë dhe standarti në fuqi.

VEZË PULE

Kërkesat cilësore

Pamja e jashtme, e pastër dhe pa plasje. Lejohen ndotje të lehta. Dhoma e ajrit (lartësia) mm, jo me shume se 9 mm.

E bardha e vezes. E dendur e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar ne ovoskop).

E verdha e vezes. Kompakte e ndodhur ne pozicionin qendror pak e levizshme.

Lejohet devijim i vogel nga pozicioni qendror.

Era: pa ere prishje dhe ere tjeter të huaj. Masa ne gr, jo me pak se 50.

Ç’do kokërr duhet te jete e vulosur ku te përmbaje markën dhe datën e skadencës.

Gjithashtu duhet qe çdo parti malli te shoqërohet me raport analizë ku kjo e fundit te përputhet me datën dhe markën e vulës.

Analiza mikrobiologjike

- Salmonella

“Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

Ambalazhimi

-Vezët ambalazhohen ne kartona fole me kapacitet 30 veze secila dhe ne çdo kuti kartoni vendosen 12 cope kartona fole.

-Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shenohen:

Marketimi,

Emri i ndërmarrjes prodhuese,

Sasia,

Data e prodhimit,

Data e skadences.

MISH PULE

Të jetë i freskët, cilësi e parë me ngjyren karakteristike te mishit te pules. Te kete ere te kendshme, pa shije dhe ere te huaj.

Te mos kete perqindje te larte dhjami.

Transporti te behet me mjetet e firmes, me furgona frigoriferike.

Te jete i ambalazhuar sipas standartit sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Materiali ambalazhues duhet të plotësojë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit dhe të shoqëruara me certifikatë cilësie.

Mishi i pules nuk perfshin koken dhe te brendshmet.

Pjeset qe do te dorezohen duhet te jene ne raport te drejte me strukturen anatomike te pules (qafe, krah, kofsh dhe gjoks).

Mishi i pules te jete i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqeruar me raport veterinar.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Raporti veterinar duhet të paraqitet në origjinal.

MISH VIÇI

Bazuar ne STASH 1441/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.

Lloji: Mish viçi i freskët, cilësia e parë.

Treguesit shqisorë:

Pamja e jashtme: Mish i butë me ngjyrë trendafil i çelët. Siperfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje, në prerje duket e ndritshme jo e ngjitshme, me ngjyrë rozë karakteristike, të ketë pak dhjamë të bardhë nën lëkurë dhe diçka më tepër në brendësi. Forma e trupit të jetë e rrumbullakosur. Duhet të jetë karkasë e plotë, ose e ndarë ne 4 pjesë, cilesi e parë.

Ngjyra: Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa që ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqe është e ndritshme, ngjyra e dhjavit është e bardhë tek kafshet e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.

Era: e këndshme, karakteristike e llojit.

Palca e kockave: Mbush plotësisht kanalën e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhë.

Lëngu i mishit pas zierjes: i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre. Kërkesa cilësore: Gjatë therjes, mishi i viçit trajtohet në gjysma trupi e në çerek. Trupi ndahet në mes të vertebrave kur ndahet në gjysmë, ndërsa ndarja në çerek bëhet ndërmjet brinjës 12 e 13.

Koka veçohet nga trupi në vertebrën e parë, këmbët tek kupa e gjurit.

Konsistenca: E butë dhe elastike, gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm.

Karakteristika e mishit të freskët nuk duhet të ketë erë të huaj dhe nuanca jeshile në sipërfaqe. Furnizimi me mish viçi të jetë në sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor pa të brendshme dhe kokë.

Tregetimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes në verë, ndërsa në dimër 12 orë.

Mishi të jetë i cilesisë së parë, i shoqëruar me raport veterinar sipas ligjeve në fuqi. Viçi duhet të jete deri 1 (një) vjeç dhe me peshë deri 150 kg.

Të mos ketë përqindje të madhe dhjami, preferohet kofshë e pasme.

Transporti të bëhet me mjetet e firmës të tipit frigoriferik të specifikuar dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.

Ruajtja në frigorifer në temperaturën nga 00 - 40 Celsius.

Mishi detyrimisht duhet të jetë i kontrolluar dhe i vëlosur nga veterineri në çdo pjesë.

Afati i garancisë: 12 orë nga koha e marrjes në dorëzim dhe përdorim. Mishi i freskët shoqërohet me dokument veterinar ditor (raport veterinar).

Mishi duhet të thëret në ambiente (thertore të licensuara), të cilat plotësojnë standartet higjieno – sanitare dhe veterinare.

Amballazhimi me qese sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor duhet të ketë vulën e kontrollit veterinar në prerjet me peshë më të madhe.

Qeset e ambalazhit duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, të jenë qese të pa-riciklueshme dhe të shoqëruara me çertifikatë cilësie.

Mishi duhet të shoqërohet çdo ditë, me raport veterinar.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë

Raporti veterinar duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

VAJ ULLIRI I VIRGJËR

STAZH 102-87

Ligji nr. Nr. 87/2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregëtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit”Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 21.3.2017 Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”

Vaji i Ullirit i Virgjër është vaji i ulliriti i virgjër i cili ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 2 gramë për 100 gramë dhe karakteristika si më poshtë:

Treguesit organo leptike:

- Pamja e jashtme te jete e kthjellat dhe pa asnjë turbullire.
- Ngjyra te jete e verdhe deri ne lehtësisht jeshile.
- Era dhe shija karakteristike te vajit te ullirit. Nuk duhet te përmbaje lende te huaja. Nuk duhet të te jete i rafinuar.
- Ambalazhimi në shishe 0.5-1 litërshe qelqi ose plastike transparente me etikete ku te shënohen standardet.

Nuk duhet të jetë i përzier me vajra te tjera dhe konservante.

Treguesit e tjerë fiziko kimik:

-Lagështia dhe lëndë fluore në % m/m $\leq 0.2\%$

-Aciditeti i lirë në % $\leq 2\%$

-Numri i peroksideve ≤ 20 mek O₂/kg

-Koeficienti i perthithjes ultraviolet (UV)- (K 1% 1cm)

*K(232) ≤ 2.60

*K(270) ≤ 0.25

*Delta K ≤ 0.01

-Numri i Jodit (Sipas Eijs) 75-94

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit . Data e skadimit.

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Produkti duhet të shoqerohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

“Raport Analiza Fiziko-Kimike” duhet të përmbajë të gjitha treguesit e kërkuar.

“Raport Analiza Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

VAJ LULE DIELLI I RAFINUAR
STAZH 2121-87 TREGUESIT ORGANO-LEPTIKE

1. Pamja ne 200 C : Leng vajor, i qarte, pa depozitime.
2. Ngjyra : E verdhe e lehte.
3. Era dhe shija :E mire karakteristike e vajit lule dielli, pa shije dhe ere te huaj e te ranciduar.

TREGUESIT FIZIKO – KIMIKE.

1. Aciditeti jo me shume se 0,4 mg KOH /GR VAJ OSE NE ACID OLEIK 0,2/GR / 100 gr vaj.
2. Lageshtia dhe lendet fluturuese ne 105 grade C jo me shume se 0.2%.
3. Dendesia relative ne 20 grade 0,918-0,923.
4. Numri i sapunifikimit (mg KOH/gr vaj 188-194).
5. Treguesit i refraksionit =1467-1469.
6. Treguesi i jodit 110-143.
7. Lende te pasapunifikueshme : jo me shume se 15 gr/kg.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Vaj lule dielli i rafinuar do te ambalazhohet ne shishe plastike me vellim 1 ose 5 litroshe, te mbyllura me tape plastike me vidhezim hermetik te kapsuluara me shirit PVC me stampen perkatese. Mbi cdo shishe do te vendoset etiketa ne te cilën do te shenohet:

Emërtimi i plote i mallit dhe data e prodhimit. Markerimi: 1-Emërtimi i prodhuesit.

2- Emri i produktit .

3- Peshë neto ose vëllimi i produktit. 4-Data e prodhimit .

5- Data e skadimit.

6- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

7- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion. Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mirë.

Produkti duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original.

ÇOKO-KREM

Treguesit organoliptike

Ambalazhimi:

Të jetë me ambalazhi plastik me masë 900-1000 gr. Në ambalazh të vendoset etiketa ku shenohen:

Ndermarja prodhuese, Lloji, data e prodhimit dhe data e skadimit, kushtet e veçanta të ruajtjes.

Era dhe shija:

Te kete ere dhe shije normale,pa ere myku ose shije tjeter te huaj,te tharte etj.

Pamja e jashtme: Mase homogjene ne forme kremi deri ne viskoze pa lende te huaja, ngjyre karakteristike e cokollates.

Treguesit Fiziko-Kimike

Yndyre jo me pak se 14% Sheqer jo me pak se 55 Permbajtja e kakaos jo me pak se 10%.

Acid laktik jo me shume 1% Permbajtja e lageshtise jo me shume se 24% Ngarkesa mikrobiale te jete brenda normave te lejuara. Mikroorganizma patogjene nuk lejohen. Produkti duhet te jete i shoqeruar me raport te rregullt analize sipas legjislacionit ne fuqi.

Produkti duhet të shoqerohet me:

Raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport analizë mikrobiologjike.

Raport Analizat duhet të paraqitet në original.

FASULE

STASH 1723/87

Treguesit Organo-leptikë

Pamja e jashtme : Kokrra te plota, te shendosha,me forme dhe madhesi sipas llojit (ovale , e rrumbullaket, e gjate etj) me gjatesi 8 – 13mm.

Ngjyra E bardhe .

Era dhe shija: Pa ere myku dhe cfaredo ere tjeter te huaj. Pas zierjes te kete ere te kendshme, pa shije te hidhur ose cfaredo ere tjeter te huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë

Lageshtia jo më shumë se 15% Lende te huaja jo me shume se 0.8%.

Kokrra te thyera jo me shume se 13%. Perzierje kokrrash jo me shume se 2.2%. Demtime mekanike nuk lejohen.

Infeksione ose demtime nga insektet nuk lejohen.

Ambalazhimi

Ambalazhimi i paketuar me peshe 1 kg, me etiketen perkatese ku te shenohet prodhuesi,data e prodhimit dhe skadenca.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit. Data e prodhimit .

Data e skadimit.

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë,këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Produkti duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje e noterizuar.

MAKARONA

STASH 1170/87

Treguesit “Organiko-Leptike” Forma: Makarona (fusilli), spirale dhe

Forma: Makarona të vogla

Sasia dhe lloji i makaronave do të përcaktohet siaps kërkesës së AK.

Pamja e jashtme: Ne forme te rregullt, te plota, me siperfaqe te lemuar deri lehtesisht te ashper .
Pas zierjes makaronat te jene elastike, te mos qulloosen, te mos cahen dhe te mos krijojne shkume.
Ngjyra: E bardhe me nuance te verdhe, ne thyerje qelqore me jo me pak se gjysma e siperfaqes se seksionit.

Era dhe shija: E mire karakteristike e makaronave pa shije te hidhur, te tharte , te mykur dhe pa cfaredo ere dhe shije tjeter te huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë

Lageshtia jo me shume se 13%. Aciditeti: Acid sulfuric jo me shume se 0,16%.

Rritja e vellimit pas zierjes jo me pak se 2 here. Insekte dhe demtues te tjere nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Makaronat te jene te ambalazhuara me qese polietileni nga 0.5 deri 1 kg, te mos jene te miellezuara, te tregohet koha e zierjes dhe tregues te tjere:

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto

Data e prodhimit .

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë. Malli duhet të shoqerohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

REÇEL

STASH 1477/87

Lloji i reçelit:

1. Reçel kombulle
2. Reçel qershie

Sasia dhe lloji i reçelit do të jetë sipas kërkesës së AK.

Treguesit cilësorë të reçelit:

Pamja e ngjyra: E mirë, me fruta me ngjyrë të njëllotë, karakteristike e llojit, pa bërthamë dhe farë. Shija dhe era: me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamalizimi e fermentimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

Konsistenca:

Masë e njëllotë, viskoze deri xhelatinoze me fruta me zierje normale.

Treguesit fiziko-kimikë:

1.Lëndët e thata sipas refraktometrit në 20 gradë C jo më pak se 65 % 2.Sheqer gjithësej (sheqer saharoz dhe I vetë frutit) jo më pak se 55% 3.Aciditeti i shprehur në acit tartik, %, jo më shumë se 1.3

4. Përmbajtja e kriprave të metaleve të rënda në mg/kg produkt jo më shumë se:

Kallaji 100

Bakri 10

Zinku 10

Plumbi 0.1

Arseniku 0.2

5. Shenja myku dhe fermentimi nuk lejohen 6.Lëndë të huaja nuk lejohen.

Raport analiza Fiziko – kimike duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Ambalazhimi:

Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi ose plastike, apo me peshe 300 gr - 1 kg, me etikete dhe të jete i shoqeruar me raport të rregullt analize sipas legjislacionit në fuqi.

Cilesia e recelit duhet të jete në përputhje me lenden e pare që është perdour për prodhim dhe sipas kerkese se Autoritetit kontraktor.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto

Data e prodhimit . Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Produkti duhet të shoqerohet me:

Raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport analizë mikrobiologjike.

Raport Analizat duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

TRAHANA

STASH 617/87

Trahana e cilësisë I

Treguesit organo leptikë:

Pamja: Mase kokrrizore e miellore. Pas zierjes praqitet mase e lidhur e njetrajtshme.

Ngyra: sipas perberesve te perdorur.

Shija dhe era :E kendshme karakteristike e trahanase pak e tharte .Pa ere e shije myku

Treguesit fiziko kimik

1- Aciditeti i shprehur ne acid sulfuric jo me shume se 0.7 2- Lageshtia % jo me shume se 13

3- Yndyra % jo me pak se 2

4- Kripa e gjelles % jo me shume se 2

5- Permbajtja e metaleve, zink, plumb dhe baker - nuk lejohen

Analiza mikrobiologjike

1- E-coli, kerpudha, myk, insekte, demtues te tjere nuk lejohen

Raport analizat duhet të përmbajnë të gjithë treguesit e kërkuar. Paketimi dhe etiketimi:

- Trahanaja paktohet ne qese plastike (polietileni) ose letre me mase 0.2-1 kg \pm 2%.

Ne cdo pako vendoset etiketa ku shenohen artikulli, masa, standarti ne fuqi, muaji dhe viti i prodhimit, data e skadencës.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto

Data e prodhimit . Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes

-Ne etikete vendoset permbajtja dhe udhezuesi i perdorimit,ruajtja dhe transporti.

-Trahanaj e prodhuar dhe e ruajtur sipas kerkesave te ketij standarti garantohet nga prodhuesi deri ne 6 muaj nga data e prodhimit.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuara.

SHEQERI

STASH 1413/87

Treguesit “Organiko-Leptikë”

Pamja e jashtme:

Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa copa sheqeri të ngjeshura ose lende të huaja, i derdhur, i thate në të prekur dhe të mos ngjitet.

Ngjyra: e bardhe dhe me shkëlqim.

Shija dhe era, Shije e ëmbël, pa shije dhe ere të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër. Tretshmëria të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyre.

Treguesit “Fiziko-Kimik”

Treguesit teknik:

- Sheqer i pastër i llogaritur në lëndë absolutisht të thatë jo më pak se 99.6%

- Lende reduktuese (sheqer invert) jo më shumë se 0,1%.

- Hiri jo më shumë se 0,07%.

- Lageshti jo më shumë se 0.16%

Ambalazhimi

-Ambalazhimi i paketuar me pako letre me peshe 1 kg, i etiketuar

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto

Data e prodhimit . Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Malli duhet të shoqerohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

ORIZ

(Cilësi e parë)

STASH 1738/87

Treguesit Organo-Leptikë

Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha , të pastra, të zhveshura teresisht nga levozhga e orizit, pa shije dhe ere myku ose prishje.

Ngjyra: E bardhe, lejohen kokrra me nuance ngjyre te verdhe.

Era dhe shija: Karakteristike e orizit te shendoshe , pa shije te tharte , te hidhur, pa ere te mykur dhe ere tjeter te huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë

- Lageshtia: jo më shumë se 15 %
- Lende te huaja jo me shume se 0,4%.
- Kokrra jeshile të pazhvilluara jo më shumë se 0.5%
- Kokrra te thyera me te vogla se gjysma jo me shume se 12%.
- Kokrra të kuqe, jo më shumë se 10%
- Kokrra te verdha jo me shume se 4 %.
- Lende minerale nuk lejohen.
- Kokrra te pazhveshura nuk lejohen.
- Te mos permbaje demtues te gjalle ose te ngordhur.

Ambalazhimi

- Ambalazhimi i paketuar ne qese ,me peshe 1 kg, i etiketuar.

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit. Data e prodhimit .

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë,këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Produkti duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje e noterizuar.

MIELL GRURI

Bazuar ne STASH 1455\87 dhe Udhëzimin nr. 207, datë 31.03.2015 I Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave “Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, përt’u shitur te konsumatori I fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”, Shtojca 3

Lloji: Miell gruri me rreze 80 % Treguesit shqisor:

Ngjyra: e bardhe me nuanca të lehte në të verdhe në varesi të llojit të grurit. Pjesëzat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.

Era dhe shija: karakteristik e miellit të grurit, pa ere myku, pa shije të hidhur, të tharta dhe pa ere e shije të huaj. Nuk lejohen kercitje.

Treguesit Fiziko-kimikë

- Lageshtira, %, jo me shume se 14.
- Aciditeti i shprehur në acid sulfurik në lëndet absolutisht të thata, %, jo me shume se 0.115
- Hiri i tretshëm, në lëndën absolutisht të thatë, %, jo me shume se 0.9.
- Hiri i patretshëm në acid klorhidrik 10%; në lëndën absolutisht të thatë, %, jo me shume se 0.1.
- Mbitjetja (imtesia e bluarjes): Për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra:
 - në siten metalike nr.54, jo me shume se 2%.
 - në siten e mendafshite 5 xxx, jo me shume se 5%.
 - Gluteni i njome, jo me pak se 25%.
 - Lende minerale . Nuk lejohen .
- Perzierje metalike. Plumbi, zinku e bakri nuk lejohen. Lejohet përmbajtja e hekurit në formë termijash nën 0.3 mm, jo me shume se 3mg/g
- Mikroorganizma patogjene, infestime dhe demtues hambari të gjalle, nuk lejohen.

-Proteina (% ndaj lëndës së thatë (vlera minimale)) 9%

Ambalazhimi dhe transporti.

Ambalazhimi ne pako letre me peshe 1kg. Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shenohen të dhenat e meposhtme. Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto

Data e prodhimit . Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë,këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkëputet nga ambalazhi.

-Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

-N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Produkti duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokpje e noterizuar.

MIELL ORIZI

STASH 1484/87

Ngjyra e bardhë.

Shija dhe aroma: karakteristike e miellit të orizit, pa shije dhe erë të thartë, pa erë myku apo çfardo shije dhe erë të huaj. Nuk lejohen kërcitjet.

Treguesit fiziko kimikë:

1. Lageshtia jo më shumë se 14.5%
2. Hiri i patretshëm në acid klorhidrik 10% dhe lëndët absolutisht të thata në % jo më shumë se 0.1%
3. Aciditeti I shprehur në acid sulfuric në lëndët absolutisht të thata jo më shumë se 0.115
4. Intësia e bluarjes në sitën metalike 54%, jo më shumë se 15
5. Lëndë minerale nuk lejohen.
6. Mikroorganizma patogjene, infektive dhe dëmtues hambari të gjallë nuk lejohen. Te jete i prodhuar me oriz cilesi e pare.

Te jete i ambalazhuar ne qeske plastike 250-500gr sipas kerkese se etnit kontraktor. Ne etikete te jene shenuar

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto

Data e prodhimit . Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes

Raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqitet në original ose e noterizuar.

THJERRËZA

STAZH 1116/87

Treguesit organo-leptikë

Kokrra te shendosha te plota,te paprekura nga semundja e insekteve qe perbejne objekt karentinor ose te prishin cilesine. Nuk lejohen perzjerje kultivaresh.

Ngjyra e kokrrave eshte bezhe deri ne kafe te celte.

Era dhe shija, karakteristike e thjerrzes. Pa ere myku e shije te hidhur dhe pa ere e shije te huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë.

-Lageshtia jo me shume se 14 %

-Kokrra thjerze te thyera jo me shume se 1%

-Perzjerje te farave te keqija jo me shume se 2%

-Lende te huaja (gjethe,pjese kercelli,levozhge etj) jo me shume se 0.5%

Ambalazhimi

Ambalazhimi i paketuar me peshe 400 g- 1 kg, me etiketen perkatese ku te shenohet prodhuesi,data e prodhimit dhe skadenca.

Markerimi

Emërtimi i plote i mallit dhe data e prodhimit. Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit . Pesha neto

Data e prodhimit . Data e skadimit.

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Produkti duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e kërkuar.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

KRIPË

Krtipë e jodizuar bazuar në STAZH 1437/01.07.1995

Lloji: kripe ushqimore perpunuar dhe e bluar per perdorim ne guzhine. Ngjyra: E bardhë

Era dhe shija: E kripur pa shije dhe ere të huaj. Pamja: Mase kokrrizore.

Treguesit fiziko kimikë:

- 1- Imtesia ne mm 0.2 – 2 .
- 2- Klorur Na ne lenden e thate ne %,jo me pak se 98.
- 3- Klorur Mg ne lenden e thate ne %,jo me shume se 0.3. 4-Sulfat Mg ne lenden e thate ne %,jo me shume se 0.9. 5-Sulfat Ca ne lenden e thate ne %,jo me shume se 0.2.
- 6-Lende të patretshme ne lenden e thate ne %,jo me shume se 0.3. 7-Lageshtire ne %,jo me shume se 1.
- 8-Jodur kaliumi mg/kg 50 + - 3.

Kripa të plotësoje të gjithë kërkesat higjieno - shëndetësore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetsise.

Amballazhimi:

Të bëhet në qese të paster ose polietileni ushqimore, pesha 0.5 deri 1 kg. Marketimi:

Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit. Data e prodhimit .

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

